

KËRKESË
Nr. 3930, datë 16.12.2019

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “LIZAM
PLLOCI”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të Komisionit të Ankimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. Lizam Plloci

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000814-5

Datë 18.11.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000814-2, datë 18.11.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Lizam Abdyl Plloci”, NIPT: G30215075S, punëdhënës Lizam Abdyl Plloci, prej datës 18.11.2019, ora 11:30 deri në datën 18.11.2019, ora 16:30.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 18.11.2019 dhe e njoftoi në datën 18.11.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: ligji nr. 9385, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 nr. 3 O.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, dënimi administrativ dhe vlera e dëmit për $8 \text{ m/st} \times 30 \text{ 000} = 240 \text{ 000}$ lekë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.6.2006, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative, si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
Gjobë 80 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:
Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:
Ervin Hysa, ID: 0301010021
Elis Bekteshi, ID: 0301010008

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti “Lizam Abdyl Plloci” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “organit epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.